

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

TREMUJORI I - 2014

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

PRILL 2014


Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

1.	SEKTORI FINANCIAR DHE BANKAT	4
2.	NDËRMJETËSIMI FINANCIAR NË SISTEMIN BANKAR	6
2.1.	NDËRMJETËSIMI NË LEKË	6
2.2.	NDËRMJETËSIMI NË VALUTË	9
3.	ECURIA E KUSHTEVE TË KREDITIMIT	13


1. SEKTORI FINANCIAR DHE BANKAT

Sistemi financiar në Shqipëri dominohet nga aktiviteti i bankave tregtare, i cili luan rolin kryesor ndërmjetësues në ekonomi. Në fund të muajit dhjetor 2013, aktivet e sistemit bankar përbënin rreth 91.3% të totalit të aktiveve financiare, krahasuar me 92% në fund të muajit shtator. Krahas sektorit bankar, roli i institucioneve të tjera financiare në zgjerimin e sistemit financiar shqiptar ka ardhur në rritje. Aktiviteti i tyre është përqendruar kryesisht në ndërmjetësimin me fonde të deficitit fiskal dhe ka tërhequr interesin e agjentëve ekonomikë në vend. Interesi në rritje i individëve ka ardhur si pasojë e dy zhvillimeve kryesore. Fillimisht, prezantimi i fondit privat të investimeve dhe instrumenteve të reja financiare me terma maturimi më të gjatë në vitin 2013, ofruan një mundësi për diversifikimin e portofolit financiar të individëve. Njëkohësisht, ndjekja e një politike monetare lehtësuese nga autoriteti monetar dhe përcjellja e saj e plotë në tregun e depozitave ka ndikuar në zhvendosjen e një pjese të kursimeve të individëve jashtë sistemit bankar, drejt instrumenteve më afatgjatë e me norma interesi më të favorshme. Të dhënat e tremujorit të parë të vitit konfirmojnë pjesëmarrje aktive të individëve në blerjen e letrave me vlerë të qeverisë edhe gjatë kësaj periudhe.



Në fund të muajit shkurt, 57.1% e stokut total të depozitave në sistemin bankar rezultojnë të ndërmjetësuar si kredi për ekonominë. Norma e ndërmjetësimit ka shënuar rënie kundrejt muajit dhjetor 2013, ku raporti i tepricës së kredisë ndaj depozitave ishte në 57.7%, si dhe rënie kundrejt një viti më parë me rreth 2

pikë përqindje. Ndërmjetësimi nga sektori bankar ka vijuar të kushtëzohet nga ecuria e dobët e kredisë për sektorin privat, e cila vijon të përcaktohet si nga kërkesa e ulët ashtu edhe nga oferta ende e shtrënguar e bankave. Aktiviteti i plogësht ekonomik dhe ecuria e dobët e konsumit, paralelisht me investimet e pakta të bizneseve gjatë kësaj periudhe, kanë përcaktuar kërkesën e ulët të sektorit privat për financim. Bankat gjithashtu kanë vijuar të ndjekin politika të kujdesshme kreditimi. Pavarësisht lehtësimit të standardeve për segmente të caktuara tregu si dhe politikës monetare stimuluese në vijimësi, normat e larta të interesit vijojnë të reflektojnë prime të larta rreziku. Përveç flukseve më të ulëta të kredisë së re dhënë gjatë kësaj periudhe, reduktimi i stokut të kredisë është ndikuar edhe nga shlyerjet e larta të portofolit dhe pjesërisht pastrimet e bilanceve të bankave nga kreditë e këqija.



Pakësimi i aktivitetit kreditues të bankave ka ndikuar në krijimin e ulët të parasë në ekonomi. Ecuria e depozitave në muajt janar dhe shkurt tregon për ngadalësim të normës së tyre të rritjes. Në fund të periudhës, stoku total i tyre rezulton rreth 1.4% më i lartë se një vit më parë, duke reflektuar, ndër të tjera, zhvendosjen e pjesëshme të depozitave drejt formave të tjera të kursimit jashtë sistemit bankar, si dhe prurjet më të pakta valutore gjatë kësaj periudhe të vitit. Ndërkohë, në muajt e fundit është vënë re një rritje më e shpejtë e depozitave të papërfshira në paranë e gjerë¹, me afat maturimi mbi dy vjet, duke konfirmuar preferencën e individëve për zhvendosje të depozitave drejt maturiteteve më të gjata. Raporti i depozitave ndaj PBB-së në fund të muajit dhjetor² rezultoi 70.1%, duke shënuar një rënie të lehtë nga një vit më parë.

¹ Në materialet dhe raportet tona, ne i referohemi analizës së stokut të depozitave që përfshihen në llogaritjen e parasë së gjerë, e cila sipas përkufizimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar përfshin depozitat me afat maturimi deri në dy vjet dhe përfshihet ato me maturim mbi dy vjet.


² Llogaritur me një vlerësim të përafërt të PBB-së nominale, bazuar në PBB-në e publikuar nga INSTAT dhe në vlerësimet e Departamentit të Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë.

2. NDËRMJETËSIMI FINANCIAR NË SISTEMIN BANKAR

Ndërmjetësimi bankar në muajt janar dhe shkurt në terma mesatarë ka ruajtur thujtë të njëjtat norma kundrejt një tremujori më parë. Rritja e raportit të ndërmjetësimit në fund të vitit të kaluar u ndikua si nga rritja sezonale e kredisë në muajin dhjetor, ashtu edhe nga reduktimi i stoku të depozitave përgjatë tremujorit të fundit. Në muajt janar dhe shkurt, vërehet një rënie graduale e normave të ndërmjetësimit kundrejt fundit të vitit. Ndërkohë që stoku i depozitave u reduktua në një masë më të ulët gjatë kësaj periudhe, rritja e kredisë në muajin dhjetor rezultoi e përkohshme dhe teprica e kredisë për ekonominë shënoi tkurrje të mëtejshme në muajt pasues. Këto zhvillime përcaktuan ecurinë në rënie të ndërmjetësimit kundrejt muajit të fundit të vitit, duke ruajtur kështu mesatarisht normat e tremujorit të fundit.


2.1. NDËRMJETËSIMI NË LEKË

Ndërmjetësimi nga sistemi bankar në monedhë vendase, në muajt janar dhe shkurt, ka ruajtur prirjen në rritje të vënë re në fundin e tremujorit paraardhës. Raporti i kredisë për ekonominë ndaj stoku të depozitave në lekë rezultoi në 44.2% në fund të muajit shkurt, rreth 1 pikë përqindje më i lartë se mesatarja e tremujorit të kaluar. Ky raport është ndikuar nga ecuria më e mirë e kredisë në lekë krahasuar me atë në valutë, e cila është nxitur si nga faktorë të ofertës ashtu edhe të kërkesës. Politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka ndikuar në reduktimin e kostos së kredisë në lekë, ndërkohë që agjentët ekonomikë janë më të ndërgjegjësuar kundrejt ekspozimit ndaj kursit



të këmbimit dhe rrjedhimisht më të tërhequr drejt kreditimit në lekë. Ndërkohë, depozitat në lekë kanë shënuar përmirësim, duke zbutur reduktimin në terma mujorë krahasuar me tremujorin e kaluar.


Depozitat në lekë në fund të muajit shkurt shënojnë një normë vjetore rritjeje prej 2.5%, nga 3.7% që regjistruan në fund të vitit të kaluar. Ecuria e depozitave në lekë pasqyron jo vetëm krijimin më të ulët të parasë në monedhë vendase gjatë kësaj periudhe, por edhe formën e mbajtjes së kursimeve nga ana e individëve. Gjatë kësaj periudhe është vënë re një zhvendosje e depozitave në depozita me maturitet mbi dy vjet, të cilat nuk përfshihen në stokun e depozitave të parasë së gjerë, si dhe drejt instrumenteve të tjerë jobankare që ofrojnë gjithashtu maturitete më të larta e norma më të favorshme interesi. Depozitat pa afat në lekë kanë vijuar të zgjerohen me ritme të shpejta, ndërsa teprica e depozitave me afat rezulton thuhet në të njëjtin nivel të një viti më parë. Depozitat e individëve kanë ruajtur ritmin pozitiv të rritjes, megjithëse kanë shfaqur ngadalësim që prej muajit tetor. Në fund të muajit shkurt, depozitat e individëve në lekë shënojnë një normë vjetore rritjeje prej 2.6%. Ndërkohë, depozitat e biznesit karakterizohen nga luhatshmëri e lartë, në reflektim të aktivitetit të bizneseve dhe nevojave të tyre afatshkurtra për likuiditet.



Struktura e kredisë sipas monedhës nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme nga fundi i vitit të kaluar. Në muajt janar dhe shkurt, kredia për ekonominë në lekë u zgjerua me ritme pozitive, duke shënuar një normë vjetore prej 2.9% në fund të periudhës. Pështja e kredisë në lekë ndaj stokut total ka shënuar një rritje të lehtë në 40.3% në fund të muajit shkurt, duke reflektuar ecurinë e mirë të kredisë për sektorin privat në monedhë vendase. Ecuria e saj u ndikua pozitivisht nga rritja e portofolit të kredisë për biznese, i cili në fund të periudhës rezultoi rreth 3.2% më i lartë se një vit më parë. Shpërndarja sipas qëllimit të përdorimit tregon se kredia për investim është rritur me ritme të shpejta në terma vjetorë në muajt janar dhe shkurt krahasuar me tremujorin e kaluar, duke dhënë dhe kontributin më të lartë në zgjerimin e tij. Ndërsa portofoli i kredisë

në lekë për qëllime likuiditeti, ka ndjekur normat ngadalësuese të shfaqura në tremujorin e paraardhës, duke regjistruar rënie të tepricës në fund të muajit shkurt.


Kreditimi në lekë për individë ka shfaqur gjithashtu performancë të mirë në muajt janar dhe shkurt, duke ruajtur normat pozitive të rritjes dhe duke shënuar rreth 3.6% rritje vjetore në fund të periudhës. Zhvillimet në këtë portofol kanë vijuar të përcaktohen nga ecuria pozitive e kredisë hipotekore në monedhë vendase, e cila në terma vjetorë ka shënuar rritje me 7.3% në fund të muajit shkurt. Normat në rritje të zgjerimit të saj kanë reflektuar produktet promovuese të bankave për këtë segment tregu, me paketa tërheqëse dhe norma të favorshme interesi. Ndërkohë, kredia dhënë individëve për konsum ka ngadalësuar normën vjetore të tkurrjes dhe rezulton thujtë në të njëjtin nivel me periudhën e fundvitit 2013.



Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka shënuar sërish rritje të lehtë në dy muajt e parë të vitit 2014. Ajo rezultoi mesatarisht 6.83 pikë përqindje, nga 6.77 pikë përqindje që shënonte mesatarisht në tremujorin e katërt të vitit 2013. Sikurse edhe në tremujorët e mëparshëm, arsyeja për tendencën në rritje të kostonë së ndërmjetësimit është shpejtësia më e madhe e reduktimit të normave të interesit të depozitave kundrejt atyre të kredisë. Në krahasim me tremujorin e mëparshëm, norma e interesit të depozitave ka rënë nga 2.5% në 2.3%, ndërkohë që ajo e interesit të kredisë ka rënë nga 9.3% në 9.2%.

Kjo dinamikë është edhe më e dukshme në ecurinë e kostonë së ndërmjetësimit kundrejt një viti më parë. Kështu, në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, norma mesatare e interesit të kredisë ka rënë me 1.77 pikë përqindje, ndërkohë që ajo e depozitave ka rënë me 2.19 pikë përqindje. Situata e mirë e likuiditetit në treg ka mundësuar një përcjellje të shpejtë të sinjaleve të politikës monetare tek normat e interesit të depozitave në lekë. Nga ana tjetër, normat e interesit të kredisë në lekë kanë shfaqur një inerci më të lartë, duke

reflektuar rrezikun e shtuar lidhur me kreditimin e sektorit privat të perceptuar nga bankat.




Në tremujorin e parë të vitit, reduktimi i normave të interesit të kredisë është reflektuar edhe në zvogëlimin e *spread*-it të tyre kundrejt *yield*-eve të bonove të thesarit 12-mujore, të cilat shërbejnë edhe si norma referencë në përcaktimin e normës së interesit të kredisë në lekë. Kjo diferencë rezultoi 5.36 pikë përqindje, nga 5.55 pikë përqindje që ishte në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Megjithatë, në krahasim me një vit më parë, *spread*-i kundrejt bonove të thesarit mbetet më i lartë, duke reflektuar rënien më të ngadaltë të normave të interesit të kredisë. Në tremujorin e parë të këtij viti, *yield*-i i bonove 12-mujore të thesarit rezultoi mesatarisht 3.76%, duke rënë me 2.62 pikë përqindje kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar.

2.2. NDËRMJETËSIMI NË VALUTË

Ndërmjetësimi i fondeve nga sistemi bankar në monedhë të huaj ka pësuar rënie. Megjithëse në nivel më të lartë se ai në lekë, raport i kredisë ndaj depozitave në valutë është ulur në 71.2% në fund të muajit shkurt, duke qenë rreth 0.7 dhe 3.9 pikë përqindje më i ulët përkatësisht kundrejt një tremujori dhe një viti më parë. Kjo ecuri reflekton kryesisht performancën e dobët të kredisë për sektorin privat, në kushtet e rritjes anemike të aktivitetit ekonomik dhe politikave ende të shtrënguara të bankave, sidomos ndaj bizneseve, si dhe zhvendosjen e preferencave të agjentëve ekonomikë drejt huamarrjes në monedhë vendase.


Ndërkohë, aktiviteti depozitues në valutë ka rezultuar gjithashtu i plogësht. Stoku total i depozitave në terma vjetorë në muajin shkurt ka mbetur thajse i pandryshuar kundrejt një viti më parë, duke shënuar rritje të lehtë me 0.2%, e ngjashme edhe me rritjen e dobët në fund të tremujorit paraardhës. Flukset e ulëta

Grafik 7. Tregues të ndërmjetësimit në valutë




valutore nga jashtë dhe krijimi i pakët i parasë në vend kanë diktuar kryesisht ecurinë e depozitave në monedhë të huaj. Zhvillimet afatshkurtra tregojnë për reduktim të tepricës së depozitave gjatë kësaj periudhe, e përqendruar në muajin shkurt. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, i cili ka rezultuar i luhatshëm gjatë kësaj periudhe, kjo rënie rezulton pak më e moderuar. Struktura kohore e tyre shfaq sjellje të ngjashme me depozitat në lekë, me rritje të shpejtë të depozitave pa afat dhe rënie të depozitave me afat. Pas një rënieje në terma vjetorë, depozitat e individëve kanë hyrë në territor pozitiv dhe në fund të muajit shkurt qëndrojnë në të njëjtin nivel si një vit më parë.

Grafik 8. Ndryshime vjetore të depozitave në valutë sipas monedhës dhe strukturës kohore



Teprica e kredisë për ekonominë në valutë ka vijuar të tkurret në tremujorin e parë të vitit, duke shënuar rënie me rreth 5% në terma vjetorë në muajin shkurt. Kjo sjellje ka evidentuar reduktimin e mëtejshëm të financimit të bizneseve, portofoli i së cilës ka thelluar rënien në rreth 6.1% në terma vjetorë. Kjo ecuri

është përcaktuar kryesisht nga reduktimi i kredisë për investime, e cila ndryshe nga portofoli në lekë, rezultoi me rënie të ndjeshme në monedhë të huaj. Paralelisht me këto zhvillime, kredia dhënë bizneseve për qëllime likuiditeti ka vijuar të shfaqet me rënie, por në masë më të moderuar se ajo për investime.




Struktura e kredisë së individëve tregon për rënie të mëtejshme të kredisë hipoteqare në valutë në muajt janar dhe shkurt, duke shënuar një normë prej -2.1% në fundin e periudhës. Ndërkohë, ecuria e kredisë për konsum shfaqet më e luhatshme, edhe për shkak të stokut të ulët të kësaj kredie. Teprica e saj ka ngadalësuar normat rënëse që u vunë re në tremujorin e fundit të vitit të kaluar.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro³ ka vijuar të rritet edhe në muajt janar e shkurt të vitit 2014, duke ndjekur tendencën rritëse prej më se një viti. Ajo rezultoi mesatarisht 5.92 pikë përqindje në këta dy muaj, nga 5.55 pikë përqindje që shënonte mesatarisht në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Kundrejt një vitit më parë, ajo është rreth 1.43 pikë përqindje më e lartë. Rritja e kostonë së ndërmjetësimit në euro është ndikuar kryesisht nga rënia e normave të interesit të depozitave, por edhe nga rritja e normave të interesit të kredive. Në kushtet e likuiditetit të bollshëm dhe të mundësive të kufizuara të investimit në këtë monedhë, bankat kanë ofruar një normë gjithnjë e më të ulët për depozitat në euro. Norma mesatare e ponderuar e këtyre të fundit rezultoi mesatarisht 1.18% në dy muajt e parë të këtij viti, duke rënë me 0.2 pikë përqindje kundrejt tremujorit të kaluar dhe me 1.0 pikë përqindje kundrejt një viti më parë. Kjo ecuri është reflektuar edhe në ngushtimin e diferencës së tyre ndaj normave të euros në tregjet ndërkombëtare (euribor), të cilat janë luhatur në nivele të qëndrueshme gjatë vitit të fundit.

³ Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.


Grafik 10. Ecuria e kosos së ndërmjetësimit në euro



Në rritjen e kosos së ndërmjetësimit në euro ka ndikuar edhe rritja e normës së interesit të kredisë. Kjo e fundit rezultoi mesatarisht 7.10%, duke u rritur me 0.16 pikë përqindje dhe 0.42 pikë përqindje përkatësisht kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe kundrejt një viti më parë. Normat e larta të interesit të kredisë në euro reflektojnë vlerësimin e lartë për rrezikun e kredisë nga ana e bankave, dhe veçanërisht për kreditë për investime afatgjata të bizneseve. *Spread-i* i tyre kundrejt normave *euribor* me maturitet 12-mujor është luhatur në nivelet 6.4-6.5 pikë përqindje gjatë 12 muajve të fundit.

3. ECURIA E KUSHTEVE TË KREDITIMIT

Në tremujorin e parë të vitit 2014, bankat kanë vijuar të ndjekin përjasje të ndryshme kundrejt kreditimit të bizneseve dhe të individëve. Kështu, ato kanë vijuar të shtrëngojnë kushtet për kreditimin e bizneseve ndërkohë që kanë lehtësuar më tej kushtet e kreditimit të individëve. Në kahun shtrëngues ka vepruar kryesisht rritja e normës së interesit për kreditë më rrezik të lartë, ndërkohë që normat e interesit për kreditë me rrezik normal dhe komisionet janë ulur. Pjesa më e madhe kushteve joçmim të kredisë kanë vepruar në kahun lehtësues.



Kushtet e kreditimit për bizneset janë shtrënguar më tej në tremujorin e parë të këtij viti, në një masë më të madhe se në tremujorin e mëparshëm, duke reflektuar shqetësimet për ecurinë e përgjithshme të ekonomisë dhe të sektorëve të veçantë të saj, si dhe nivelin e lartë të kredive me probleme. Ndër elementet jokosto të kredisë, bankat kanë forcuar vetëm kërkesat për kolateral, ndërkohë që elementet e tjera kanë dhënë një ndikim neutral ose në kahun lehtësues.

Standardet e kredisë për individë janë lehtësuar më tej në tremujorin e parë të këtij viti, në një masë më të ulët se në tremujorin e kaluar. Të gjithë elementet jokosto kanë vepruar në krahun lehtësues të kushteve të kreditimit, me përjashtim të kërkesave për kolateral, të cilat kanë mbetur të pandryshuara në këtë tremujor.